

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR THE PREVENTION OF CORRUPTION

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 02.11.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-2673/22, për zyrtarin e lartë z. Jetish Maloku, Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lart z. Jetish Maloku, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e rastit për situatë të mundshme të konfliktit të interesit, pas pranimit të kërkesës (DPKI-06-2673/22) nga raportuesi i jashtëm, me pyetjen se *“a ka konflikt interesi me rasti e propozimit dhe votimi fillimisht si anëtar e më pas kryetar i Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës z. Jetish Maloku, në Komisionin për rekrutimi të prokurorëve të rinj”*.

Konform procedurave të brendshme, Agjencia përmes shkresës zyrtare (DPKI-06-02/2713/22) e ka njoftuar z. Maloku për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, e njëkohësisht nga i njëjti ka kërkuar sqarime dhe dokumentacionin relevant përkitazi me themelimin e Komisionit për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit. Në përgjigjen e kërkesës së



Agjencisë, Këshilli Prokurorial i Kosovës përmes shkresë zyrtare (DPKI-06-02/2713-1/22) ka ofruar sqarimet dhe dokumentacionin e kërkuara nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacioni në dispozicion, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka gjetur se, në takimin e 216-të të Këshillit Prokurorial të Kosovës i mbajtur me 17.06.2022, në mes tjerash është nxjerr edhe Vendimi KPK/Nr.789/22 për themelimin e Komisionit për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit, me kryesues z. Jetish Maloku.

Lidhur me vendimin për themelimin e Komisionit për Rekrutimin, sipas kërkesës së Agjencisë, z. Maloku ndër të tjera ka deklaruar se vendimi në fjalë është nxjerrë konform kompetencave të Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të përcaktuar me nenin 11 paragrafi 2, nënparagrafi 2.7 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ndërsa propozimi i përbërjes së Komisionit nga Kryesuesi i KPK-së dhe hedhja në votim si pikë e rendit të ditës është bërë konform Rregullores Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës (neni 21). I njëjti ka sqaruar se, *“Bazuar në këtë dispozitë ligjore si dhe praktikën e mëhershme Kryesuesi i Këshillit, propozon emrat e anëtarëve të Komisioneve të përhershme dhe ad-hoc, mirëpo çdo herë është bërë me dije anëtarëve të Këshillit se munden ti japin propozimet për anëtarët e tjerë të Komisioneve, dhe vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm sipas Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës”* (DPKI-06-02/2713-1/22).

Më pas, Këshilli Prokurorial i Kosovës përmes shkresës zyrtare (DPKI- 06-02/2713-2/22) e ka njoftuar Agjencinë se Këshilli ka nxjerr Vendimin KPK/Nr.842/2022 përmes së cilit e ka anuluar Vendimin KPK/Nr.278/2022 për themelimin e Komisionit për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit, dhe se lidhur me këtë çështje me Vendimin KPK/Nr.843/22 është formuar komisioni i ri me përbërje të re.

Referuar nenit 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, z. Maloku ka deklaruar se, *“Bazuar në këtë dispozitë ligjore asnjëri nga anëtarët e Komisionit Rekrutues nuk kanë interes privatë të jenë pjesë e komisionit.”*

Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion, sqarimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe akteve ligjore e nënligjore të Këshillit, Agjencia ka konstatuar se në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, ashtu siç është përcaktuar me neni 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, respektivisht, *“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare.”*

Kjo për faktin se, me Ligjin Nr.06/L-056 për këshillin Prokurorial të Kosovës është përcaktuar se:

“Kryesuesi i Këshillit ka këto autorizime:

[...] Me pëlqimin e Këshillit, propozon anëtarët e komisioneve të përhershme siç ceket me këtë ligj, dhe ndërmerr detyra të tjera sipas udhëzimit të Këshillit.” (neni 11 paragrafi 2 nënparagrafi 2.7).

Pastaj, sipas ligjit në fjalë është kompetencë e Këshillit themelimi i komisioneve të përhershme dhe të përkohshme sipas nevojës së Këshillit. Tutje, Rregullorja Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës, në nenin 21 paragrafi 3 ka përcaktuar se: *“Pas përfundimit të shqyrtimit, Kryesuesi propozon marrjen e vendimeve dhe hedhë në votim çdo pikë të rendit të ditës veç e veç.”*

Sa i përket Komisionit për Rekrutim të Prokurorëve, me Rregulloren Nr.02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, në nenin 2 dhe 3 është përcaktuar se:

“Komisioni për Rekrutim përbëhet nga pesë (5) anëtarë të rregullt dhe dy (2) anëtarë rezervë.”
Anëtarët e Rregullt të Komisionit për Rekrutim janë:

Tre (3) anëtarë të Këshillit, njeri nga tre anëtarët duhet të jetë jo prokuror
Dy (2) prokuror nga prokuroritë.”


Nga Procesverbali KPK/Nr.1258/2022 i takimit të 218-të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në të cilin është nxjerr vendimi për themelimin e Komisionit për Rekrutimin e Prokurorëve, vërehet se z. Maloku është tërhequr nga votimi me rastin e votimit të propozimit të një anëtari tjetër të Këshillit që z. Maloku të jetë anëtar/kryesues i Komisionit, e njëjtë ka vepruar edhe anëtari tjetër i Këshillit A.B., ndërsa anëtari tjetër nga radhët e Këshillit B.K. nuk ka qenë prezent kur është propozuar dhe votuar.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, në lidhje me nenin 29, paragrafi 4 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

